



ДРЖАВЕН ЗАВОД ЗА РЕВИЗИЈА
ENTI SHTETËROR I REVIZIONIT
STATE AUDIT OFFICE

ENTI SHTETËROR I REVIZIONIT - Njoftim për mediumet -

Shkup, 10.07.2025

Buxheti shtetëror burim dominant i financimit për fushatat zgjedhore të Zgjedhjeve Parlamentare 2024

Nga të ardhurat dhe shpenzimet totale të pjesëmarrësve në fushatën zgjedhore, në vlerë prej 368.710 mijë denarë, 244.769 mijë denarë (63%) janë siguruar nga Buxheti i shtetit, për reklamat e tyre politike me pagesë

Enti Shtetëror i Revizionit, në përputhje me Programin Vjetor të Punës për vitin 2024 dhe nenin 85 të Kodit Zgjedhor, kreu revizion financiar së bashku me revizionin e pajtueshmërisë të raporteve të përgjithshme financiare të llogarive "për fushatë zgjedhore" të të gjithë pjesëmarrësve në Zgjedhjet Parlamentare të vitit 2024.

Me revizion u përfshinë raportet e përgjithshme financiare të llogarive transaksionare "për fushatë zgjedhore" të: Koalicionit „Për të Ardhmen Evropiane“ i udhëhequr nga LSDM, Koalicionit „Maqedonia Jote“ i udhëhequr nga VMRO–DPMNE, Koalicionit „Guxim për Maqedoninë“ i udhëhequr nga Opsioni Qytetar për Maqedoninë – GROM, Koalicionit „Fronti Evropian“ i udhëhequr nga BDI, Partisë Politike E MAJTA, Koalicionit VLEN, Lëvizjes ZNAM – Për Maqedoninë Tonë, - Maqedonia e Vetme, PP Alternativa e Re Shkup, Partisë Politike AVAJA, Lëvizjes Qytetare Evropiane, - Epoka e Tretë Maqedonase / Listat e Pavarura Maqedonase, Partia Jote, Rodina Maqedonia, PP E DJATHTA, PP DEMOKRATËT Shkup dhe Partia e Punëtorëve.


Për secilin nga pjesëmarrësit në fushatën zgjedhore është përgatitur raport i veçantë i revizionit, në të cilin është shprehur opinion për raportin e përgjithshëm financiar dhe për pajtueshmërinë me rregullativën ligjore relevante, udhëzimet dhe politikat e vendosura.

Sipas dedikimit janë reviduar totali i të ardhurave dhe shpenzimeve të realizuara sipas burimeve, si dhe respektimi i afateve për hapjen dhe mbylljen e llogarive të transaksionit „për fushatën zgjedhore“, regjistrimi dhe fshirja e pjesëmarrësit në regjistrin e

subjekteve juridike transparenca dhe llogaridhënia përmes përgatitjes dhe dorëzimit të raporteve financiare për të ardhurat dhe shpenzimet e realizuara gjatë fushatës zgjedhore pranë Entit Shtetëror të Revizionit.


Të ardhurat totale për fushatën zgjedhore të të gjithë shtatëmbëdhjetë pjesëmarrësve janë në shumën prej 386,710 mijë denarë dhe përfshijnë të ardhurat e realizuara në llogaritë transaksionale „për fushatën zgjedhore“ (140,978 mijë denarë), të ardhurat nga donacionet në në sende/mallra (963 mijë denarë) dhe të ardhurat e siguruar nga buxheti i shtetit për publikim të reklamave politike të paguara (244,769 mijë denarë), që tregon se 63.3% e të ardhurave totale janë siguruar nga Buxheti i Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe janë paguar nga Komisioni Shtetëror Zgjedhor, ndërsa 26.7% janë mjete të siguruar nga burime tjera të financimit.

Të ardhurat sipas burimeve në 000 denarë dhe pjesëmarrja e tyre në totalet



Pjesëmarrjen më të madhe në totalin e të hyrave ka Koalicioni „Maqedonia Jote“ i udhëhequr nga VMRO–DPMNE (37%), pasuar nga Koalicioni „Për të Ardhmen Evropiane“ i udhëhequr nga LSDM (25%), Koalicionit „Fronti Evropian“ i udhëhequr nga BDI (15%), Koalicionit VLEN (13%), Partisë Politike E MAJTA (4%), Koalicionit „Guxim për Maqedoninë“ i udhëhequr nga GROM (2%) ndërsa pjesëmarrja e pjesëmarrësve tjerë është nën 1%.


Nga ana KSHZ për RPP të radiodifuzerëve dhe medimeve të publikuara dhe portalet e internetit, janë paguar gjithsej 244.769 mijë denarë, ose 3.979.984 euro, për 16 (gjashtëmbëdhjetë) pjesëmarrës në Zgjedhjet Parlamentare 2024.



Mjetet e paguara në 000 denarë për reklamimin e paguar politik për pjesëmarrës në fushatë zgjedhore

Shpenzimet totale të kryera nga pjesëmarrësit në fushatën zgjedhore për zgjedhjen e deputetëve në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë së Veriut janë në shumën prej 386.710 mijë denarë, nga të cilat 140.261 mijë denarë janë pagesa nga llogaritë transaksionale, 963 mijë denarë janë shpenzime në bazë të donacioneve të pranuar në mjete jo-monetare dhe 244.769 mijë denarë janë shpenzime për RPP. Mjetet financiare të pashfrytëzuara nga llogaritë transaksionale “për fushatën zgjedhore”, të cilat në pajtim me raportet financiare janë paraqitur si shpenzime në shumën totale prej 717 mijë denarësh, janë kthyer në llogaritë për funksionim të rregullt të partive politike.

Pjesëmarrjen më të madhe në shpenzimet totale – 63,3% – e zënë shpenzimet për RPP, pasuar nga shpenzimet e paguara nga llogaritë transaksionale për blerje të mallrave dhe shërbimeve, me 36,3%. Mjetet e paguara nga llogaritë transaksionale “për fushatën zgjedhore” në shumën totale prej 140.261 mijë denarësh kanë të bëjnë me pagesa për: blerje të materialeve, shpenzime të tjera materiale, shërbime komunale, shërbime transporti, reklamë dhe propagandë, përfaqësim, shërbime intelektuale, shërbime kontabiliteti, organizim të tubimeve parazgjedhore, marrje me qira të hapësirave gjatë fushatës zgjedhore, komisione për pagesa dhe kompensime për shërbime bankare, si dhe shpenzime të tjera.



** Totali i mjeteve të shpenzuara në 000 denarë nga llogaritë transaksionale sipas dedikimit*

Pjesëmarrësi në fushatën zgjedhore, për financimin e aktiviteteve të veta zgjedhore, mund të shpenzojë më së shumti 110 denarë për çdo votues të regjistruar në njësinë zgjedhore, si në rrethin e parë edhe në rrethin e dytë të votimit. Sipas të dhënave nga KSHZ numri i përgjithshëm i votuesve të regjistruar në listën zgjedhore për Zgjedhjet Parlamentare 2024 është 1.815.350 persona. Shuma maksimale e mjeteve që mund të shpenzojë secili nga pjesëmarrësit në fushatën zgjedhore është 199.689 mijë denarë.

Me revizionin kryer është konstatuar se asnjë nga pjesëmarrësit nuk ka realizuar shpenzim më shumë se maksimumi i përcaktuar me ligj. Më së shumti mjete janë shpenzuar në fushatën zgjedhore për Koalicioni „Maqedonia Jote“ i udhëhequr nga VMRO–DPMNE (72% nga maksimumi i përcaktuar me ligj), pasuar nga Koalicioni „Për të Ardhmen Evropiane“ i udhëhequr nga LSDM (49%), Koalicioniit „Fronti Evropian“ i udhëhequr nga BDI (29%), Koalicioniit VLEN (25%), Partisë Politike E MAJTA (8%), Koalicioniit „Guxim për Maqedoninë“ i udhëhequr nga GROM (4%), ndërsa pjesëmarrësit tjerë anë shpenzuar mjete në shumë prej 1% ose ndër 1% nga maksimumi i përcaktuar me ligj.

Jo të gjithë pjesëmarrësit në fushatën zgjedhore siguruan respektimin e afatit për mbylljen e llogarive transaksionale “për fushatën zgjedhore” dhe fshirjen nga regjistri i personave juridikë si dhe transparencë, gjegjësisht deri te ESHR-ja nuk dorëzuan pjesë nga raportet për të ardhurat dhe shpenzimet e realizuara të llogarive transaksionale “për fushatën zgjedhore”.

Për zgjedhjet e mbajtura parlamentare 2024, pjesëmarrësit në fushatën zgjedhore PP Alternativa e Re, Lëvizja Qytetare Europiane dhe Epoka e Tretë Maqedonase, deri te ESHR-ja nuk i kanë dorëzuar raportet e plotë financiar me specifikimin e shpenzimeve për të hyrat dhe shpenzimet në fushatën zgjedhore, me çka kanë kryer kufizim në fushëveprimin e revizionit.

Si dhe në revizionet e mëparshme për fushatat zgjedhore, edhe për këtë proces zgjedhor theksojmë nevojën për rirregullim të Kodit Zgjedhor sidomos në pjesën e:

- financimin e fushatës zgjedhore me mjete nga llogaria e rregullt e partisë politike të siguruara nga Buxheti i shtetit, si dhe afatin përfundimtar për depozitimin e donacioneve;
- përcaktimi i kriterëve matëse në pjesën e sigurimit dhe ndarjes së mjeteve nga Buxheti i shtetit, të dedikuara për reklama politik me pagesë;
- mënyra se si donatorët do të dëshmojnë/konfirmojnë që nuk janë „persona të lidhur“ me radiodifuzerët, mediat e shkruara dhe mediat elektronike (portalet në internet) gjatë financimit ose dhënies së donacioneve për partitë politike;
- kushtet dhe kriteret që duhet të përmbushin mediat elektronike për të pasur mundësi të aplikojnë për reklamë politike në Komisionin Shtetëror të Zgjedhjeve;
- përcaktimi i kriterëve të qarta dhe të sakta për shpërndarjen e mjeteve buxhetore të dedikuara për reklamë politike të paguar në mediat elektronike (portalet në internet);
- caktimi i organit kompetent për monitorimin dhe raportimin e paraqitjes mediatike zgjedhore në mediat elektronike (portalet në internet);
- vendosjen e një sistemi interoperabël/zgjidhje softuerik për shkëmbimin dhe kontrollin e të dhënave për aktivitetin e banerëve i cili do të ketë mundësi teknike për mbledhjen e të dhënave metrike dhe statistikore;
- parashikimi i gjobave dhe për mediat elektronike (portalet elektronike) në rast të mosdorëzimit të Raportit për hapësirën reklamore të shfrytëzuar nga secili pjesëmarrës në fushatën zgjedhore dhe mjeteve të cilat janë paguar të të kërkuara për këtë qëllim dhe
- sigurimi i edukimit për pjesëmarrësit në fushatën zgjedhore për mënyrën e përgatitjes së raportit të plotë financiar me specifikimin e shpenzimeve për të hyrat dhe shpenzimet në fushatën zgjedhore.

Press kontakt:

Albiona Mustafa Muhaxhiri +389 72228 203 albiona.mustafa@dzr.gov.mk

Mijaļe Durgutov +389 70 358 486 mijalce.durgutov@dzr.gov.mk

Martin Duvnjak +389 75 268 517 martin.duvnjak@dzr.gov.mk